



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi _ dhe nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit nga parashtruesi nga, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) në vazhdimin e senacës së 42-të, të mbajtur me datë 14.12.2020 morri

VENDIM

Procedura për lëndën e formuar pas denoncimit me nr. 12-715/1 me datë 31.01.2020 dorëzuar nga parashtruesi nga, **NDËRPRITET**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për lëndën me numër 12-715 nga viti 2020, formuar në bazë të denoncimit me numër 12-715/1 me datë 31.01.2020.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK me sqarimin.

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e vendimarrjes.

Sqarim

Me denoncimin është dorëzuar edhe shtojcë e denoncimit me numër 12-715/2 me datë 11.03.2020 në të cilën janë theksuar informata shtesë në lidhje me akuzat e lëndës.

Në denoncimin e dorëzuar dhe e plotësuar e njëjta, janë theksuar akuza për pakënaqësi për veprimet e Këshillit gjyqësor të RMV pas ankesës të cilën parashtruesi e dorëzoi me muajin Korrik të viti 2019, dhe për të cilën ende nuk ka marrë përgjigje.

Gjatë rishikimit të rastit të lëndës, Komisioni shtetëror i merrë parashysh akuzat e parashtruesit dhe e konstatoi këtë:

- Denoncimi i dorëzuar në fakt paraqet ankesë nga Këshilli gjyqësor i RMV deri tek i cili dorëzoi ankesë, parashtruesi në denoncim, në muajin Korrik të viti 2019, pas të cilës ende nuk ka marrë përgjigje, dhe kërkon nga KSHPK të ndihmon në këtë drejtim.
- Në ankesën e dorëzuar deri tek Këshilli gjyqësorë, parashtruesi shpreh pakënaqësi nga veprimi i Gjykatës Themelor në Kavadarç në proces gjyqësor të udhëhequr në procedurë për dëmshpërblim të personit që ka marrë lëndime trupore në aksident komunikacioni në vitin 2007, në të cilën edhe ky ishte pjesëmarrës që ndërhyr dhe person që duhet të paguaj dëmin. Parashtruesi thekson se nga ana e pjesëmarrës tjetër si person i lënduar, ka qenë dorëzuar kërkesë për dëmshpërblim nga SHA-polisa e sigurimit (maq. AD-Osiguritelina polisa) mirëpo nuk iu pagua dëmi, dhe ai me datë 09.04.2018 dorëzoi padi kundër kompanisë së sigurimeve

dhe mbi bazë të dokumenteve të falsifikuara i ishin konstatuar lëndime të rënda trupore, kurse aktgjykimi është marrë në favor të këtij dhe shtëpia e sigurimeve ia pagoi dëmin.

Kundër parashtruesit si palë e involvuar – pjesmarrës në rastin, i cili në atë kohë ka qenë i mitur, është udhëhequr procedurë penale dhe para Gjykatës themelor në Veles me datë 24.04.2008 është marrë vendim për veprë penale të bërë – rast i rëndë kundër sigurisë në komunikacion, kurse parashtruesit nuk dha ankesë. Pasiqë u ngrit procedura për dëmshpërblim në vitin 2008 nga ana e pjesmërrësit tjetër si person i lënduar dhe iu dha kompensim, parashtruesi dha ankesë në procedurë qytetare ku vendimet janë marrë në dëm të tij dhe pastaj është ngritur dhe procedurë penale për rastin.

Gjegjësisht, parashtruesi dha denoncim deri tek Avokati i popullit, Ministria e shëndetësisë (e cila i ka kontrolluar akuzat dhe ka konstatuar parregullësi) kurse dorëzoi edhe denoncim penal deri tek PTHP Kavardarc, mirëpo tre vjetë pas denoncimit të rastit, me datë 07.12.2010 dhe pas të cilës nga ana e prokurorit publik përgjegjës është marrë vendim me datë 13.12.2010 me të cilën i rrefuzohet denoncimi sepse veprat e denoncuar nuk janë vepra penale për të cilat ndiqet penalisht me detyrë zyrtare. Parashtruesi dha ankesë dhe kërkoi përsëritje të procedurës dhe udhëheqi procedurë subsidijare në të cilën Këshilli për vepra penale pran Gjykatës themelore në Kavardarc i rrefuzoi ankesat e parashtruesit dhe është ndërprerë procedura penale, kurse me datë 12.07.2011 Gjykata Apelit ia rrefuzoi ankesën parashtruesit dhe e vërtetoi aktgjykimin e shkallës së parë të gjyqit. Në mënyrë plotësuese, deri tek PTHP Kavardarc me datë 07.02.2010 përsëri është dorëzuar denoncimi penal i njëjtë, e cila ka qenë rrefuzuar sepse vetëmse ka pasë procedurë për të njëjtën në vitin 2010 kur edhe është dorëzuar edhe vendimi.

I pakënaqur me veprimin, parashtruesi është drejtuar edhe deri tek Prokuroria e Lartë Publike në Shkup e cila ka vepruar dhe ka bërë vëzhgim në lëndën dhe ka sugjeruar që PTHP Kavardarc përsëri të vepron dhe të ndërmerr veprime përkatëse, me çka është vepruar dhe nga gjyqi i shkallës së parë është kërkuar eksperizë të dokumentacionit mjekësor për rastin e cila është dorëzuar në procesin gjyqësor. Ekspertiza ka zgjatur 15 muaj për fajin e gjykatësit hetues, dhe pas aritjes së përfundimit nga ekspertiza ka vazhduar procedura penale dhe lënda është kthyer në rigjykim me datë 07.03.2013 kurse hetimi për procedurën është ndërprerë me datë 15.05.201_ nga Gjykata Penale pas dorëzimit të ankesës nga të akuzuarit. Në këtë është dorëzuar nga PTHP Kavardarc e cila është pranuar dhe lënda është kthyer në rivendosje, kurse me datë 05.01.2018 nga ana e Gjykatës penale është marrë Vendim se ndërpritet procedura penale përshkak të rastit të vjetëruar në lidhje me ndjekjen penale, kurse nga ana tjerë Gjykata e Apelit e përsëritë aktgjykimin kurse në pjesën e shpenzimeve e shfryqizoi dhe e ktheu në rivendosje.

Nga ana e PTH të RMV me datë 18.09.2019, parashtruesi është informuar se kanë vepruar për ankesën për vendimin e marrur, kan bërë kontrollim dhe ka konstatuar se në rastin është marrë vendim i duhur i prokurorit publik.

Përndryshe, në vitin 2015 në lidhje me rastin e lëndës PTHP Kavardarc ngriti aktpadi kundër punëtorëve mjekësor për bërjen e veprës penale falsifikim të dokumenteve zyrtare – dokumentacionit mjekësor për rastin konkret, në periudhën prej 10.07.2007 deri në fund të viti 2007 dhe i mundësuan që personit me plagët në trup të marrin kualifikim të lëndimeve të rënda trupore edhe pse realisht bëhet fjalë për lëndime të lehta trupore me

çka që personit të lënduar i mundësun në procedurë gjyqsore të merr sasi më të madhe të pronës. Në lidhje me aktakuzën veproi Gjykata Themelore në Kavadar si gjyq primar kompetent dhe me datë 05.01.2018 morri Vendim me të cilin ndërpritet procedura penale përshkak të vjetërsimit sepse ka kaluar dy herë kohë nga ajo që nevojitet që sipas Ligjit kërkohet për vjetërsim të ndjekjes penale (*gjegjësisht deri në fund të viti 2017 kanë kaluar 10 vite nga momenti i veprës*). Pala e dëmtuar është udhëzuar në proces gjyqsor civil, për realizim të kërkesës për të drejtë së pronës në procedurën e lëndës.

Parashtruesi tregon se me këtë rast disa herë është drejtuar deri tek Këshilli Gjyqsor, kurse për herë të fundit nga ana e Këshillit Gjyqsor ka marrë lajmërim me datë 06.08.2019 se pas ankesës së tij është formuar lëndë pas të cilës procedura është në rrjedhë e sipër në lidhje me kontrollimin e akuzave të lëndës. Ai dyshon se në procedurë janë bërë lëshime thelbësore, prandaj kërkon nga të gjitha institucionet deri tek të cilat është drejtuar të veprojnë në rastin dhe të bëjnë kontrollë të gjykatës dhe të Këshillit gjyqsor të cilët nuk kanë vepruar plotësisht për lëndën e tij.

Për vërtetim të plotë të gjendjes faktike pas hapjes së lëndës, KSHPK kërkon të dhëna dhe informacione nga Këshilli Gjyqsor i Republikës së Maqedonisë së Veriut për atë se deri ku është procedura për lëndën e formuar për akuzat e dorëzuara nga parashtruesi i denoncimit. Nga Këshilli gjyqsor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me datë 04.12.2020 informojnë se personi, me ankesë të vulosur me numër/..... është drejtuar deri tek Këshilli Gjyqsor, për veprimet e Gjykatës Themelore në Kavadar, dhe në përputhje me kompetencat e veta ligjore, Këshilli gjyqsor veproi për ankesat, i ndërmorri veprimet e nevojshme për kontrollim të akuzave të theksuara në denoncimin dhe në seancën e Këshillit të mbajtur me datë 26.02.2020 e rishikuan procedurën, me çka parashtruesit iu dorëzua lajmërim UPP nr...../.... me datë 19.05.2020 të cilën e dorëzojnë si shtesë të informimit.

Në bazë të të konstatuarës më lartë, KSHPK vërtetoi se në rastin e lëndës bëhet fjalë për akuza për çështje të cilat nuk janë në kompetenca për veprim ndaj tyre, por bëhet fjalë për çështje lidhur me veprime kompetente të organeve tjera, të cilët vepruan për të njëjtat dhe ndërmorrën veprime në përputhje me kompetencat e veta ligjore. Duke pasë parasysh gjendjen e këtyllë faktike, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vlerëson se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm në rastin e lëndës dhe gjithashtu KSHPK nuk ka kopetenca ligjore në lidhje me kërkesën për kontroll të gjyqit dhe të Këshillit Gjyqsor; procedura për lëndën ndërpritet dhe lënda duhet të mbyllet dhe të akrivohet.

Duke pasë parasysh të theksuarën më lartë, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi në dispozitë të këtij vendimi.

Është vendosur e datë 14 Dhjetor 2020, me numrë 12-715/5

Dorëzuar deri tek: Arkiva, parashtruesi
Punoi: J.C., këshilltarë
Miratoi: G. T., anëtarë i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËRORE PËR
PARANDALIM TË
KORRUPSIONIT
Kryetarë: Biljana Ivanovska**